



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 7 Prot.

Tiranë, më 06 / 01 / 2020

V E N D I M

Nr. 1, Datë 06 / 01 / 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.87 Regj., datë 23.07.2019, të M. Sh, kundër Spitalit Rajonal Durrës, me pretendimin e diskriminimit për shkak të *“aftësisë së kufizuar¹”*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, M. Sh ka përfunduar studimet në vitin 2016 dhe ka kryer praktikën profesionale pranë Spitalit Rajonal Durrës (SRD) gjatë periudhës 04.04.2017-04.07.2017.

Me datë 26.12.2017 është emëruar Specialiste pranë Sektorit të Kostos pranë këtij Spitali, përmes një kontrate me afat të caktuar (zëvendësim i një punonjëse me leje lindjeje) deri me datë 09.07.2018.

Nëpërmjet shkresës me nr.1891 prot., datë 18.07.2018 ankuesja ka paraqitur kërkesë për pozicionin e Specialistit pranë Burimeve Njerëzore të SRD, i cili ishte shpallur në njoftimin e buletinit zyrtar në faqen e APP nr.28, datë 16.07.2018 dhe nr.39, datë 01.10.2018.

Pas përfundimit të konkurimit znj.Sh iu komunikua se nuk ishte shpallur fituese, por i ofruan pozicionin e “Receptionistes”, të cilin ajo e pranoi megjithë pretendimin se ishte nën kualifikimin e saj profesional dhe i papërshtatshëm për aftësitë e saj ndryshe.

¹ Referuar Vendimit nr.853, datë 28.03.2019 të KMCAP/ DRSHSSH Durrës.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Nga data 18.10.2018-03.07.2019 ankuesja ka punuar si receptioniste, me kontratë me afat të caktuar, duke zëvendësuar punonjësen A.Ç e cila ishte me leje lindjeje.

Nëpërmjet shkresës me nr.1321 prot., datë 05.07.2019 ankueses i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me SRD, për shkak të mbarimit të kontratës me afat të caktuar, si rezultat i kthimit të punonjësës A.Ç nga leja e lindjes.

M. Sh trajtimin e SRD e sheh si diskriminues, pikërisht për shkak të aftësisë së saj të kufizuar, pasi thekson se referuar kuadrit ligjor punëdhënësi ka detyrim punësimin me prioritet të personave me aftësi të kufizuar, në respektim të raportit 1:30, të numrit të punonjësve; si dhe për shkak se, punonjësja A.Ç të cilën ajo zëvendësonte nuk është kthyer në pozicionin që mbante para se të merrte lejen e lindjes, atë të Receptionistes por në atë të Koordinatorës, pra largimi i ankueses me këtë argumentim nuk qëndron dhe është i pavërtetë. Ankuesja pretendon se meqenëse ky pozicion ishte i lirë, pas emërimit të A.Ç në pozicionin e Koordinatorës, ajo nuk duhej larguar nga puna por duhej emëruar në këtë pozicion.

Po ashtu, ankuesja pretendon se i ka kërkuar Drejtores së SRD të emërohet në pozicionin e Ekonomistes pranë këtij Institucioni, duke qenë se punonjësja që mbante këtë pozicion ishte larguar jashtë shtetit, kërkesë e cila nuk është marrë në konsideratë.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit nga ana e punëdhënësit dhe emërimin e saj në pozicionin “Ekonomiste e lartë”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me shkakun e pretenduar.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr.1140/1 prot., datë 30.07.2019 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues Spitalit Rajonal Durrës, lidhur me pretendimin e ankueses.
- Nëpërmjet shkresës me nr. prot.1495/1, datë 15.08.2019, Spitali Rajonal i Durrësit (SRD)⁴ informon Komisionerin se, ankuesja ka filluar punë zëvendësuese për herë të parë, në SRD me datë 26.12.2017, bazuar në shkresën me nr.2545 prot., datë 22.12.2017, të Drejtorit të SRD. Znj.Sh i është ndërprerë marrëdhënia e punës me SRD për arsye të përfundimit të kontratës së punës me afat të caktuar (pasi është kthyer nga leja e lindjes znj.K. S të cilën kishte zëvendësuar).

Në shkresë citohet se: *“Me datë 15.10.2018, në SRD u zhvillua intervista⁵ për vendin vakant të “Specialistit të Burimeve Njerëzore”, në të cilën ankuesja u rendit e dyta. Ndërkaq, me datë 18.10.2018, bazuar në “Rregulloren mbi marrëdhëniet me personelin” të SRD⁶, në Kodin e punës, si dhe në ushtrim të kompetencave të tij, Drejtori i SRD, nisur së pari nga statusi i znj.Sh si person me aftësi të kufizuara, bazuar dhe në pëlqimin e saj, ka emëruar atë në pozicionin “Receptioniste”, në Shërbimin e Poliklinikës së Specialiteteve, për zëvendësimin e znj.A. Ç, e cila ishte me leje lindjeje”.*

SRD citon në vijim se: *“...me datë 05.07.2019, M. Sh është njoftuar për ndërprerjen e kontratës me afat të caktuar, bazuar në kontratën me afat të caktuar me nr.2605/1 prot., datë 19.10.2018, për arsye të kthimit në punë të znj.A. Ç, por marrëdhënia financiare shkëputej në datën 03.08.2019, në përfundim të lejes së zakonshme të ankueses”.*

⁴ Si dhe është sjellë pranë KMD-së kopje e dokumentacionit të kërkuar.

⁵ Shkresa me nr.2572 prot., datë 15.10.2018.

⁶ Neni 15, në pikat 1,3,4 të tij, i kësaj Rregulloreje, kanë përcaktuar se:

“Emërimi pa konkurim vendoset nga Drejtori, kur kërkohet të plotësohet sa më parë një kategori postesh pune. Emërimi pa konkurim zbatohet edhe për kategori të tjera postesh pune, si specialist të mesëm ose punëtorë. Drejtori, për nevoja të ngutshme në plotësimin e vendeve të punës, emëron në vendet vakante edhe ata punonjës ose kandidatë, të cilët mund të kenë konkuruar më parë për vende të tjera pune, të shpalluar për konkurim dhe janë vlerësuar në tre vendet e para”.

Me datë 12.07.2019, Sektori i Burimeve Njerëzore i SRD, ka nxjerrë lajmërimin për “Konkurim të brendshëm” në pozicionin “Specialist i Lartë në Sektorin e Financës”, për shkak të largimit të znj.K. S, konkurim për të cilin ankuesja është njoftuar personalisht nga Drejtori i Spitalit dhe Shefi i Sektorit të varësisë, nëqoftë se do ta shihte të arsyeshme të merrte pjesë.

Me datë 18.07.2019, në SRD është zhvilluar intervista për vendin vakant për pozicionin “Specialist i Lartë i Sektorit të Financës”, ku ankuesja u rendit e treta.

Drejtori i SRD, shpjegon se: *“Në të njëjtën kohë, në zbatim të Rregullores së SRD dhe dispozitave në fuqi që më jep statusi i drejtorit, mendova që znj.Sh, duke përfituar statusin e personit me aftësi të kufizuar, të emërohet në punë definitive, në pozicionin “Receptioniste”, pozicion që u krijua nga largimi i znj.A. Ç, për arsye se ajo doli fituese në intervistën e zhvilluar për pozicionin e “Specialistit të Lartë në Sektorin e Financës”, pozicion të cilin M. Sh e mbulon që prej datës 31.07.2019”.*

Lidhur me pretendimin e ankueses se është diskriminuar për shkak të ndërprerjes së kontratës, SRD shprehet se ky pretendim nuk qëndron, për faktin se kontrata ka qenë me afat të caktuar dhe si e tillë, ka patur të përcaktuar datën e fillimit dhe të përfundimit të marrëdhënies të punës, dhe për më tepër ka patur të bëjë me zëvendësimin e një punonjëseje me leje lindjeje.

Lidhur me pretendimin e ankueses se znj.A. Ç nuk është kthyer në pozicionin e mëparshëm pas mbarimit të lejes së lindjes, pasi sipas së cilës është caktuar në një pozicion tjetër, SRD shprehet se nuk qëndron, për faktin se znj.A. Ç është kthyer në pozicionin “Receptioniste” të cilin e mbante dhe para lejes së lindjes, vërtetuar dhe më faktin se në këtë detyrë/pozicion ajo ka bërë dhe dorëzimet tek ankuesja, para se ajo të fillonte lejen e lindjes. Nëpërmjet shkresës me nr.2597 prot., datë 17.10.2018 znj.A. Ç është emëruar në pozicionin e “Koordinatorës”, pozicion të cilin për arsye personale ajo e ka refuzuar.

SRD shprehet se: *“Ankuesja ka kërkuar të futet në vendin e krijuar me largimin e Specialistes së Sektorit të Financës, por duke qenë se për këtë pozicion pune kishte disa kërkesa nga punonjës të tjerë të brendshëm, atëherë përzgjedhja për këtë pozicion pune u bë me konkurs të brendshëm. Ndaj ankueses nuk është bërë asnjë lloj diskriminimi dhe se në të dy rastet e punësimit të saj është marrë në konsideratë statusi si person me aftësi të kufizuar”.*

Nga ana e SRD është theksuar se, pozicioni i Receptionistes nuk mund të quhet pozicion me kualifikim të ulët, sikundër pretendon ankuesja, sepse në të njëjtat kushte gjatë konkurimit për këto pozicione, që ankuesja i mori pa konkurs, ato kandidatë që kanë konkuruar kanë qenë të gjithë me arsim të lartë dhe me titullin “Master”.

SRD ka theksuar faktin që: *“Gjatë periudhës që Drejtuesja e SRD ka qenë e emëruar dhe për të cilën ankuesja ka pretenduar se e ka diskriminuar, znj.Sh është emëruar dy herë në punë, një herë si zëvendësuese dhe herën e dytë definitive. Statusi i personit me aftësi të kufizuar nuk i jep të drejtë asnjë individit të shprehet në mënyrë jo të drejtë ndaj akteve ligjore dhe aktivitetit të*

Institucionit ku punon. Ankuesja është emëruar definitive në SRD që nga data 31.07.2019 dhe nuk ka qëndruar asnjë ditë pa punë”.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së M. Sh, Komisioneri me datë 23.10.2019⁷ realizoi një seancë dëgjimore me palët në proces.

Seanca u zhvillua me praninë e të dy palëve në proces: subjektit ankues, personalisht, dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, SRD, përfaqësuar nga Drejtorja e këtij Institucioni, znj.N.J.

Gjatë seancës dëgjimore, të dyja palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në. Nga ana e ankueses u theksua kërkesa e saj për t'u emëruar si ekonomiste e lartë pa konkurs, me argumentimin se ka konkuruar tre herë për këtë pozicion dhe nuk ka fituar. Ndërkohë që përfaqësuesja e SRD thekosi faktin se për pozicionet e punës "specialist i lartë", siç ishte dhe pozicioni i pretenduar nga znj.Sh, nuk mund të veprohej me emërime pa konkurim. Sa i takon emërimit në pozicionin aktual të ankueses, që është brenda tagrit që i njeh Rregullorja "Për marrëdhëniet e punës së personelit" e SRD, ajo e ka emëruar pa konkurim, pikërisht bazuar në kompetencat e titullarit të këtij Institucioni. Znj.N.J theksoi gjithashtu faktin, se në pozicionin e "Receptionistes" janë dhe shtatë punonjëse të tjera që njëjloj si ankuesja janë me arsim të lartë, fakt që nuk u kundërshtua nga ankuesja.

Në vijim të seancës, me anë të shkresës me nr.1495/3 prot., datë 12.11.2019, SRD ka dërguar kopje të "Rregullores "Për marrëdhëniet e punës së personelit" e SRD dhe të procedurës për pozicionin "Ekonomist i lartë", shpallur në muajin tetor 2017⁸.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë të pretenduar nga subjekti ankues.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

M. Sh ka përfunduar studimet e larta dhe konkretisht zotëron diplomë bachelor në Financë/Fakulteti i Ekonomisë dhe diplomë masteri profesional në Menaxhim Turizëm/Fakulteti i Ekonomisë pranë Universitetit të Tiranës. Ajo ka kryer praktikën profesionale pranë Spitalit Rajonal Durrës (SRD) gjatë periudhës 04.04.2017-04.07.2017.

⁷ Referuar "Njoftimit për seancë dëgjimore" me nr.1140/3 prot., datë 07.10.2019.

⁸ Kjo procedurë nuk mund t'i nënshtrohet shqyrtimit administrative përpara KMD-së, pasi është jashtë afatit ligjor për shqyrtimin e ankesës, sipas parashikimit ligjor të LMD-së.

Nëpërmjet Urdhërit nr.2545 prot., datë 22.12.2017 është emëruar Specialiste pranë Sektorit të Kostos pranë këtij Spitali, përmes një kontrate me afat të caktuar (zëvendësim i punonjës K. S, e cila ishte me leje lindjeje) deri me datë 09.07.2018.

a) Lidhur me emërimin e përkohshëm të ankueses për pozicionin e Ekonomistit të Lartë pranë SRD, në muajin Shator 2017, Komisioneri vlerëson se ky pretendim i saj nuk mund t'i nënshtrohet procedurës hetimore pasi:

Emërimi i ankueses në pozicionin e Ekonomistes së Lartë, në Sektorin e Kostos pranë SRD, për zëvendësimin e punonjës K.S, e cila ishte me leje lindjeje, ka ndodhur me datë 22.11.2017⁹. Ankuesja ka patur mundësi ta kundërshtonte emërimin e saj të përkohshëm, në rast mos dakordësie, që në momentin e njohjes me të, pasi ajo e ka pranuar atë pozicion në dijëni të plotë të faktit se ishte punonjëse zëvendësuese, deri në përfundimin e raportit mjekësor të punonjës K.S. Ndërsa theksojmë se, ankesa është regjistruar pranë KMD-së me datë 23.07.2019, rreth dy vite pas ndodhjes së këtij fakti, pra më vonë se një vit nga marrja dijëni.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose një vit nga marrja dijëni nga i dëmtuari, për këtë fakt”, pretendimi i ankueses për sa më lart, nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e kësaj pjesë të ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

b) Lidhur me konkurimin e ankueses për pozicionin e Specialistit të Burimeve Njerëzore pranë SRD.

Referuar dokumentacionit përkatës rezulton se, nëpërmjet shkresës me nr.4049/1 prot., datë 04.07.2018, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka urdhëruar Spitalin Rajonal Durrës për “...ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambjenteve dhe hapësirave në institucionet shëndetësore, dhe lejon të kryejë vetëm procedurën standarde të konkurimit për vendin e lirë I (një) specialist i lartë për Burimet Njerëzore pranë SRD”.

Në zbatim të sa më sipër, nëpërmjet shkresës me nr.2379 prot., datë 19.09.2018, SRD i drejtohet Agjencisë së Prokurimit Publik për publikimin e kërkesës së tyre, lidhur me shpalljen për plotësimin e një vendi vakant si specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore, publikim i cili u shpall në Buletinin nr.39, datë 01.10.2018 të APP-së.

⁹ Referuar Urdhërit të Brendshëm me nr.2545 prot., datë 22.12.2017 të Drejtorit të SRD.

Referuar procesverbalit me nr.2572 prot., datë 15.10.2018 të Sektorit të Burimeve Njerëzore të SRD, rezulton se për këtë pozicion pune kanë konkuruar tre kandidatë, të cilët janë renditur respektivisht:

- A.V, me 28 pikë në total.
- Subjekti ankues, me 18,7 pikë në total.
- G. S, me 9,7 pikë në total.

Nëpërmjet Urdhërit me nr.2572/1 regj., datë 17.10.2018 të Drejtorit të SRD, znj. A. V është emëruar Specialiste e Burimeve Njerëzore.

Nga verifikimi që iu bë dokumentacionit të dosjes së kandidatës fituese rezulton se ajo zotëron diplomë të nivelit të parë dhe të nivelit të dytë në Ekonomi dhe Menaxhim/Universiteti “Tor Vergata” Romë/Itali, me rezultate të larta. Po ashtu ka kualifikimin akademik si “Doktor Magjistrat” në Shkencat e Ekonomisë dhe të Sipërmarrjes, lëshuar nga Universiteti “Tor Vergata” Romë/Itali. Pra, në kontekst të sa mësipër, znj.A. V ka rezultuar fituese, bazuar në pikëzimin më të lartë të saj krahasur me kandidatët e tjerë (përfshirë dhe ankuesen) nga ana e Komisionit të Vlerësimit.

Bazuar në sa mësipër, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë apo të pafavorshëm në vlerësimin me pikëzim, krahasuar me kandidaten e shpallur fituese, nga ana e SRD, e për rrjedhojë as në shpalljen e saj jofituese lidhur me këtë konkurim.

c) Lidhur me konkurimin e ankueses për pozicionin e Specialistit të lartë të Sektorit të Financës pranë SRD.

Nëpërmjet njoftimit për konkurim të brendshëm me Urdhërin nr.1338/3 prot., datë 12.07.2019 të Drejtorit të SRD, është hapur procedura e konkurimit të brendshëm për pozicionin vakant “Specialist i lartë i Sektorit të Financës”, të krijuar në Administratën e SRD. Referuar procesverbalit me nr.1338/6 prot., datë 18.07.2019 të Sektorit të Burimeve Njerëzore të SRD, rezulton se për këtë pozicion pune kanë konkuruar tre kandidatë, të cilët janë renditur respektivisht:

- A.Ç, me 19.4 pikë në total.
- E. Rr, me 19.2 pikë në total.
- Subjekti ankues, me 16.8 pikë në total.

Nëpërmjet Urdhërit me nr.1338/7 regj., datë 31.07.2019 të Drejtorit të SRD, znj.A. Ç është emëruar “Specialiste e lartë e Sektorit të Financës”.

Nga verifikimi që iu bë dokumentacionit të dosjes së kandidatës fituese rezulton se ajo ka rezultuar fituese, bazuar në pikëzimin më të lartë të saj krahasur me kandidatët e tjerë (përfshirë dhe ankuesen) nga ana e Komisionit të Vlerësimit.

Në kontekst të sa mësipër, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë apo të pafavorshëm në vlerësimin me pikëzim, krahasuar me kandidaten e

shpallur fituese, nga ana e SRD, e për rrjedhojë as në shpalljen e saj jofituese lidhur me këtë konkurim.

Ndërsa, sa i takon pretendimit të ankueses se kandidatja e shpallur si fituese për pozicionin e “Specialistes së lartë të Sektorit të Financës”, në të njëjtën kohë ishte e emëruar si “Kordinatore” pranë SRD, Komisioneri konstaton se:

- Nga këqyrja dhe verifikimi i dokumentacionit, rezulton se, pas përfundimit të lejes së lindjes znj.A. Ç ka marrë në dorëzim detyrën e “Receptionistes”, detyrë të cilën kishte pasur para ezaurimit të lejes.
- Në vijim, me Urdhërin nr.2597 prot., datë 17.10.2018 znj.A. Ç është emëruar në detyrën e “Kordinatorit” pranë SRD.
- Znj.A. Ç nëpërmjet shkresës me nr.2597/1 prot., datë 18.10.2018 falenderon Drejtorin e SRD për vlerësimin e bërë ndaj saj përmes emërimit në këtë pozicion, por bën me dije se për arsye të angazhimeve familjare dhe arsye shëndetësore të saj, nuk mund ta pranojë atë. Ajo kërkon të emërohet rishtaz tek pozicioni i receptionistes, ai pozicion që kishte para këtij emërimi, pasi e vlerëson më të përshtatshëm për situatën e saj, duke cituar se: *“Kërkoj të qëndroj në detyrën e receptionistes, deri sa të krijohet mundësia për të konkuruar për një pozicion me arsim të lartë, bazuar në diplomën dhe arsiminim tim specifik në Fakultetin Ekonomik”*.
- Me datë 19.10.2018 deri me datë 01.08.2019 punonjësja A. Ç (receptioniste) ka qenë me raport leje-lindjeje dhe ndrëkaq është zëvendësuar nga ankuesja.
- Kështu, nëpërmjet Urdhërit me nr.2605 prot., datë 18.10.2018 ankuesja është emëruar Receptioniste, si zëvendësuese e punonjësës A. Ç, me leje lindjeje.
- Nëpërmjet Vendimit me nr.1321 prot., datë 05.07.2019 ankueses i ndërpritet marrëdhënia e punës me SRD, për arsye të kthimit në punë nga leja e lindjes të punonjësës A. Ç.
- Nga data 11.07.2019 – 01.08.2019 ankuesja ka përfutuar lejen e zakonshme.
- Me Vendimin nr.1321/1 prot., datë 31.07.2019 të Drejtorit të SRD znj.M. Sh është emëruar në detyrën e “Receptionistes”, me kontratë me afat të pacaktuar.
- Deri me datë 18.07.2019, datë kur dhe ankuesja dhe punonjësja A. Ç kanë konkuruar për pozicionin e shpallur vakant, “Specialiste e lartë e Sektorit të Financës”; të dyja kanë qenë në pozicionin e receptionistes, pra pretendimi se ajo mbante pozicionin e “Kordinatores” nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e znj.Sh se është diskriminuar nga ana e SRD pasi është emëruar në një pozicion pune më të ulët se kualifikimi/arsimimi i saj, nga këqyrja dhe vlerësimi i dokumentacionit të dosjes, Komisioneri konstaton se, përveç ankueses në këtë pozicion pune ka dhe punonjëse¹⁰ të tjera të cilat zotërojnë diploma të arsimit të lartë, pra, ajo nuk është trajtuar në mënyrë jo të favoforeshme apo të pabarabartë me punonjëset e tjera, përse i takon arsimimit të saj.

¹⁰ Punonjëset G.V, J.M, I.L.

Po ashtu, pranë SRD ka dhe punonjës të tjerë me aftësi të kufizuara¹¹, që do të thotë se aftësia e kufizuar nuk ka shërbyer si shkak për të cilën ankuesja të trajtohej në mënyrë jo të barabartë sa i takon emërimin të saj pranë SRD.

Nga ana tjetër, ankuesja nuk është ankuar pranë KMD-së për zhvillim apo vlerësim të padrejtë të procedurës së konkurimit në vetvehte, por ka pretenduar se, duke qenë më aftësi të kufizuar, ajo nuk duhej t'i nënshtrohej fare konkurimit, por duhet të emërohej pa konkurs.

Bazuar në Rregulloren “Për marrëdhëniet e punës të personelit” të Spitalit Rajonal Durrës, emërimi pa konkurim zbatohet vetëm për kategoritë e punës si specialistë të mesëm ose punëtorë, dhe kjo kompetencë i njihet Drejtorit. Kështu, neni 15 i kësaj Rregulloreje ka përcaktuar se, emërimi pa konkurim vendoset nga Drejtori, në rastet kur:

“1. Kërkohej të plotësohet sa më parë një kategori postesh pune. 2. Me anë të ngritjes në detyrë, të lëvizjes paralele ose kur, gjatë një konkurimi, nuk janë paraqitur të paktën tre kandidatë. 3. Për kategorinë e posteve të punës si specialistë të mesëm ose punëtorë...”

Në kontekst të sa më sipër, Drejtorja e SRD ka emëruar ankuesen në pozicionin e “Receptionistes”/specialiste e mesme, duke u bazuar në kompetencat që Rregullorja e Brendshme e SRD i jep asaj, pasi vetëm për këtë kategori pozicionesh ajo mund të bëjë emërimin pa konkurim. Për pozicionet e tjera, përfshirë dhe pozicionin për të cilin ka aplikuar ankuesja, atë të specialistit të lartë, duhet të zhvillohet patjetër konkurs, sipas rregullave të caktuara në Urdhërat dhe Udhëzimet specifike të Ministrisë të Shëndetësisë, si dhe përcaktimeve të vetë Rregullores së Brendshme të SRD.

Lidhur me pretendimin e ankueses se ajo duhet të emërohej në pozicionin e specialistes së lartë pa konkurim, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, përse kohë aktet nënligjore përcaktojnë të kundërtën.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk është ekspozuar para një trajtimi të pabarabartë dhe disfavorizues nga ana e SRD krahasuar me punonjëset e tjera “Receptioniste” për shkak të arsimimit të saj, dhe as me kandidatet e tjera që kanë konkuruar për pozicionin e “Specialistit të lartë”, për shkak të aftësisë së kufizuar, pasi kriteri për t’iu nënshtrohet konkurimit është i përcaktuar me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe është i detyrueshëm, i arsyeshëm dhe proporcional në raport me funksionin për të cilin konkurohet. Pra, konkursi në këtë rast nuk mund të konsiderohet si element i tepërt, jo i arsyeshëm, jo objektiv dhe aq më tepër diskriminues, bazuar në shkakun që ankuesja bart.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me

¹¹Punonjëset R.C, Sh.Gj.

Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Spitali Rajonal Durrës nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë apo të padrejtë.

Në mungesë të një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Spitalit Rajonal Durrës, për shkakun e pretenduar nga ankuesja.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të M. Sh, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Spitalit Rajonal Durrës.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim
Shkaku: Aftësia e kufizuar